



Skema e Granteve

Si pjesë plotësuese e tre komponentëve kryesorë dhe në mbështetje të tyre, pjesë e Programit është dhe Skema e Granteve. Kjo Skemë do shërbejë si mjet për të mbështetur qëndrueshmërinë e disa fushave të programit si dhe promovimin e qasjeve të reja që synojnë rritjen e bashkëpunimit mes aktorëve kryesorë lokalë.

Gjinia dhe Diversiteti

Një fushë e rëndësishme e Programi do të jenë çështjet gjinore, diversiteti dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Projekti do të synojë afrimin e njerëzve me përkatësi të ndryshme etnike, minoritare, gjinore, orientimi seksual, statusi socio-ekonomik, moshe, aftësie fizike, besimi fetar, bindje politike apo ideologjike, dhe do të stimulojë bashkëpunimin dhe përfshirjen në zhvillimin e partneriteteve.



Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Rr. Fadil Rada
Pall. "Gener 2", Tirana - Albania

Tel: +355 44511340

E-mail: info@cp-project.al

www.cp-project.al

www.asp.gov.al



FORCIMI I POLICIMIT
NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

2017 – 2020

Hyrje

Programi njih dhe synon të çojë përpara rezultatet e arritura nga “Programi Suedezo - Shqiptar për Policimin në Komunitet”, Faza I, si dhe kontribuon në progresin e fushave të zgjedhura si prioritete nga Policia e Shtetit. Programi financohet nga Suedia dhe synon të sjellë Policinë e Shtetit Shqiptar sa më pranë standardeve të Bashkimit Europian.

Policia e Shtetit Shqiptar, që është përfituesi kryesor i programit dhe Ekipi i Manaxhimit të Programit do të punojnë me një rrjet të gjerë aktorësh e partnerësh, përfshirë institucionet shtetërore, pushtetin vendor, organizatat e shoqërisë civile, mediat, etj. në të gjithë territorin e vendit.

Bazuar në Teorinë e Ndryshimit, objektivi kryesor i Programit është:

- Rritja e besimit dhe partneritetin të ndërsjellë mes Policisë së Shtetit dhe Komuniteteve për të krjuar fqinjësi të sigurtë.

Programi do të ofrojë asistencë në 3 komponentë të ndërlidhur me njëri tjetrin:

- 1) Mbështetja e përqendruar për Policimin në Komunitet në 2 Drejtori Vendore të Policisë
- 2) Mbështetja për Menaxhimin Strategjik
- 3) Mbështetja për Dhunën në Familje



Komponenti 1

Mbështetja e përqendruar për Policimin në Komunitet në dy Drejtori Vendore të Policisë Ky komponent bazohet ne parimin se Policimi në Komunitet përfshin policinë, komunitetet, strukturat e pushtetit vendor dhe institucionet e tjera shtetërore.

Në terma më konkrete, puna e përbashkët në nivel qarku, do të fokusohet në:

1. Mbështetjen për rritjen e kapaciteteve operacionale, të manaxhimit, të administrimit, të komunikimit etj, të të gjithë stafit të dy drejtorive të Policisë të përzgjedhura.
2. Mbështetjen materiale për përmirësime infrastrukturore.
3. Mbështetjen për rritjen e përgjegjshmërisë së policisë, nëpërmjet krijimit ose përmirësimit të grupeve të komunitetit, të cilët do të angazhohen për të adresuar problemet e sigurisë.

Komponenti 2

Mbështetja për Menaxhimin Strategjik
Mbështetja në këtë fushë do të ketë tre drejtime:

1. Zhvillimi i kapaciteteve të Monitorimit dhe Vlerësimit.
2. Mbështetja për komunikim.
3. Mbështetja për koordinim.

Fokusi i mbështetjes për menaxhimin strategjik do të përqendrohet në të dyja nivelet, si në atë qendror ashtu dhe atë vendor.

Komponenti 3

Dhuna në familje

Fusha të identifikuar dhe të mundshme për ndërhyrje janë:

1. Vazhdimi i trajnimeve të thelluara për stafin e policisë dhe jo vetëm.
2. Asistencë për strehëzat për viktimat.
3. Zhvillimi i aktivitete parandaluese dhe ndërmjetësuese.

Këto aktivitete të trajtimit të dhunës në familje do mbështeten dhe nga skema e granteve.